

Vendim nr. 143 datë 05.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “EKOBETON” SH.P.K.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2569, datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 551, datë 01.07.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1141, datë 26.04.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 1 i protokollit të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Ekobeton” sh.p.k. (kërkuesja) dhe i ndjeri A.K. kanë lidhur një aktmarrëveshje në datën 17.11.2004, sipas së cilës A.K. i vë në dispozicion shoqërisë “Ekobeton” sh.p.k. pasurinë e paluajtshme me nr. 8/381, sipërfaqe trualli + ndërtesë, gjithsej 686 m², me qëllim ndërtimin e një pallati shumëkatësh mbi këtë pasuri. Aktmarrëveshja është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, të cilat kanë rënë dakord për të drejtat dhe detyrimet që do të realizonte secila prej palëve nënshkruese të kësaj aktmarrëveshje. Kërkuesja, me vendimin nr. 04, datë 28.04.2005 të KKRT-së së Bashkisë Elbasan, është pajisur me leje ndërtimi për objektin me 11 kate + nënçati + 2 kate bodrum + 1 kat magazinë bodrum + 3 kate dyqane, me sipërfaqe 6330 m².

2. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtetsja M.K., e cila është një nga trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të të ndjerit A.K., ka paraqitur kërkesëpadi kundër kërkueses. Ajo ka pretenduar se nga kërkuesja nuk është zbatuar aktmarrëveshja e datës 17.11.2004 dhe konkretisht neni 5 i kësaj aktmarrëveshjeje, pasi nuk u është dhënë trashëgimtarëve të të ndjerit A.K. sipërfaqja prej 20 % e objekti që do të ndërtohej e llogaritur mbi sipërfaqen totale të miratuar për ndërtim. Kërkuesja, gjithashtu, ka ushtruar kundërpadi, duke pretenduar se paditësja posedon ambiente në kundërshtim me kontratën dhe duhet të bëjë lirimin e pronës të llojit dyqan, të paguajë qiranë nga momenti i posedimit, si rezultat i posedimit me keqbesim të sendit dhe në kundërshtim me aktmarrëveshjen. Paditësja nuk ka legjitimim aktiv për kreditorët e tjerë. Kërkimet janë personale dhe duhet të ushtrohen nga çdo person që ka pretendimin. Në nenin 5 të aktmarrëveshjes përcaktohet qartë se investitori do t’i japë pronarit 20% të sipërfaqes së objektit që do të ndërtohet, të llogaritur mbi sipërfaqen totale 1000 m².

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2569, datë 05.11.2011, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar kërkuesen t’i dorëzojë palës kundërshtare sipërfaqen prej 255.82 m², si dhe rrëzimin e kundërpadisë. Ajo ka arsyetuar se qëllimi që palët kanë pasur në kohën e lidhjes së aktmarrëveshjes së datës 17.11.2004, ishte përfitimi nga investitori i 20 % të sipërfaqes totale të miratuar për ndërtim. Leja e ndërtimit është nxjerrë pas aktmarrëveshjes për një sipërfaqe ndërtimore prej 6330 m², ndaj paditësja dhe trashëgimtarët e tjerë duhet të përfitonin edhe diferencën prej 255.82 m².

4. Gjykata, gjithashtu, ka arsyetuar se paditësja M.K. si një nga trashëgimtarët ligjorë të ndjerit A.K., në kushtet kur efektet juridike të kontratave shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal, si dhe në kushtet kur me padinë objekt gjykimi ajo kërkon sendin nëpërmjet përmbushjes së detyrimit të aktmarrëveshjes, paditësja ka legjitimimin aktiv të kërkojë ekzekutimin tërësisht të detyrimit për të gjithë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit (neni 692 i Kodit Civil (KC)).

5. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja, me pretendimin se paditëses i mungojnë tagrat e përfaqësimit për kreditorët e tjerë dhe se investitori ka respektuar me rigorozitet detyrimin kontraktual.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 551, datë 01.07.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me arsyetimin se gjykata e rrethit me të drejtë ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e M.K., si një nga trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit A.K., duke detyruar të paditurën t'i dorëzojnë asaj dhe trashëgimtarëve të tjerë sipërfaqen prej 255.82 m², me arsyetimin se palët kanë pasur për qëllim në momentin e lidhjes së aktmarrëveshjes, në cilësinë e pronarit, të përfitonte në masën 20% të sipërfaqes totale të miratuar për ndërtim nga pala e paditur në cilësinë e investitorit. Sipërfaqja prej 20% që paditësja dhe trashëgimtarët e tjerë të A.K. kanë përfituar është 898.04 m² dhe ajo që duhej të përfitonin mbi bazën e totalit të sipërfaqes së ndërtuar është 1266 m², e cila duke përjashtuar sipërfaqet e përbashkëta është 1153.86 m². Nga kjo sipërfaqe ata kanë përfituar 898.04 m² pra 255.82 m² më pak.

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesja në datë 30.07.2014, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se në nenin 5 të kontratës (aktmarrëveshjes) përcaktohet qartë se investitori do t'i japë pronarit të pasurisë 20% të sipërfaqes së objektit që do të ndërtojë, të llogaritur mbi sipërfaqen totale të miratuar për ndërtim, përkatësisht sipërfaqen totale 1000 m², të shpërndarë sipas kateve. Pra, kjo sipërfaqe ka qenë e përcaktuar për të gjithë trashëgimtarët e të ndjerit A.K. dhe ka pasur si vlerë absolute kufirin 1000 m².

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1141, datë 26.04.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se në të nuk ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit, prandaj, si i tillë, nuk duhet të pranohet. Gjykata e Apelit e ka respektuar ligjin procedural dhe atë

material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë. Vendimi i saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nuk vihen re shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjyqimit.

9. Në datën 27.04.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkeses

10. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për një gjykim të drejtë*, pasi gjykatat kanë legjitimuar paditësen në kërkimin e saj edhe për trashëgimtarët e tjerë, ndërkohë që ajo nuk ka legjitimim aktiv, pasi i mungojnë tagrat e përfaqësimit për kreditorët e tjerë. Kërkimet janë personale dhe ushtrohen në mënyrë të veçantë nga çdo person që ka pretendime për mospërmbushjen e detyrimeve.

9.2. *Së drejtës së pronës*, pasi ajo është e garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës dhe gjithashtu në nenin 149 të KC-së përcaktohet se pronësia është e drejtë për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendin brenda kufijve të caktuar me ligj, e drejtë që i buron edhe nga nenet 296, 298, 304 305 të KC-së. Gjykatat duke pranuar kërkesëpadinë kanë disponuar për pasuri të cilat tashmë nuk i përkasin më kërkeses, por personave të tretë të lidhur me kontratë sipërmarrje, duke cenuar edhe të drejta pasurore të personave të tretë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkeses

11. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin

përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Duke analizuar respektimin e këtyre kriterëve në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara, duke provuar interesin e tij në çështjen e parashtruar.

13. Kërkuuesja ka plotësuar edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ajo i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuuesja nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 27.04.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i datës 26.04.2022. Nga informacioni i marrë pranë Gjykatës së Lartë rezulton se sipas regjistrit në të cilin pasqyrohen datat e veprimeve për vendimin, ai është bërë i disponueshëm për palët në datën 16.06.2022 dhe gjithashtu është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 20.06.2022, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur në Gjykatë haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Në këto kushte, kërkuuesja nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të Gjykatës për këto pretendime.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.